

Fondacioni Rinor Evropian

Mbështetje e të rinjve në Europë



**Dedikuar
rinisë**

Dialog
Mundësi
Komunitet
Partneritet
Me gjithë zemër
Interaktiv
Fleksibël
Shkëmbime
Profesional



KËSHILLI I EVROPËS

■ Këshilli i Evropës (KiE) - me 47 shtetet anëtare dhe një popullsi të kombinuar prej mbi 800 milionë njerëz - u krijua në vitin 1949 për të siguruar që mizoritë e luftës së Dytë Botërore mos të ndodhnin përsëri. Puna e tij është e veçantë sepse në çdo gjë që bën është e bazuar në vlerat e tij thelbësore: të drejtat e njeriut, demokracia dhe sundimi i ligjit.

■ Është organizata e vetme në botë ku liderët e rinj marrin vendime krah për krah me përfaqësuesit e qeverisë për prioritetet, programet dhe politikat e rinisë.

ÇFARË ËSHTË FONDACIONI RINOR EVROPIAN?

■ Fondacioni Rinor Evropian (FRE), i themeluar në vitin 1972, luan një rol kryesor në punën e Këshillit të Evropës për të inkurajuar bashkëpunimin midis të rinjve në Europë dhe për të lehtësuar pjesëmarrjen e tyre aktive në shoqërinë civile dhe vendimmarrjen politike. Për më shumë se 40 vjet FRE ka ofruar ndihmë dhe fonde për aktivitete rinore të cilat promovojnë të drejtat e njeriut, demokracinë, tolerancën dhe solidaritetin.

■ FRE ju jep të rinjve zë në jetën politike e demokratike dhe mjetet që u duhen për të funksionuar efektivisht në shoqëritë e sotme të larmishme.





DËSHIRONI TË DINI SHIFRAT TONA?

■ Çdo vit, FRE e vendosur në Qendrën Rinore Europiane në Strasbourg, të Këshillit të Europës, shpërndan rreth 3 milion € për projektet rinore.

■ FRE mbështet mesatarisht një aktivitet rinor për çdo ditë pune në Evropë - 300 grante që përfshijnë mbi 15.000 të rinj në vit. Më shumë se 370,000 të rinj Europeanë kanë përfituar drejtpërdrejt nga projektet e FRE-së.

ÇFARË KA TË RE?

■ I ri-strukturuar në vitin 2013, roli i FRE-së për të ndihmuar në formësimin e aktiviteteve që mbështet është forcuar. Stafit FRE-së është i gatshëm për të ofruar këshilla e udhëzime miqësore dhe për të vlerësuar përmbajtjen dhe metodologjinë. Ata duan të dinë se çfarë aplikantët synojnë të arrijnë dhe ndikimin e rezultatet e projekteve të tyre.

■ Duke qene se buxheti i FRE-së buron nga të ardhurat publike, të gjitha aplikimet analizohen në mënyrë të detajuar dhe vlerësohen me qëllim sigurimin e transparencës dhe përgjegjëshmërisë dhe për të parandaluar mashtrimin. Grantet duhet të rimbursohen (plotësisht ose pjesërisht) në rast parregullsisht apo gabimesh. Sanksione shtesë zbatohen në rast mashtrimi.

■ Faqja e re e interaktive e internetit e FRE-së: <http://eyf.coe.int> - përfshin mjete informative dhe argëtuese si edhe një mori materialesh mësimore të ofruara nga ne dhe organizatat e regjistruara.

KUSH MUND TË APLIKOJË?

- ▶ Organizata rinore ndërkombëtare prezente në të paktën 7 vende anëtare
- ▶ Rrjete ndërkombëtare të organizatave rinore prej të paktën 7 vendeve anëtare
- ▶ Rrjete Rajonale të organizatave rinore prej 4- 6 vende anëtare
- ▶ Organizata Kombëtare rinore në një prej vendeve anëtare



■ Këto organizata duhet të jenë Jo Fitimprurëse dhe Jo Qeveritare, me statutin e tyre, të drejtohen nga dhe për të rinjtë të moshës 15 – 30 vjeç dhe që realizojnë punë në një linjë më vlerat e Këshillit të Europës

ÇFARË MBËSHTESIM NE?

■ FRE mbështet aktivitetet, studime, hulumtime, materialeve dhe dokumentacion në përputhje me punën dhe vlerat e Këshillit të Evropës. Aktivitetet zakonisht duhet të mbahen në një ose më shumë shtete anëtare të FRE-së.

■ Projektet duhet të jenë të dizajnuara për:

- ▶ forcimin e paqes dhe bashkëpunim;
- ▶ promovimin e bashkëpunimit më të ngushtë dhe mirëkuptimit midis të rinjve;
- ▶ inkurajimin e shkëmbimit të informacionit;
- ▶ stimulimin e ndihmës reciproke.

■ Ato duhet gjithashtu të përshtaten me prioritetet e sektorit rinor të Këshillit të Europës (shiko faqen e internetit për më tepër)

... DHE ÇFARË NUK MBËSHTESIM?

- ▶ Projektet komerciale
- ▶ Ndërtimin ose blerjen e pajisjeve ose objekteve
- ▶ Aktivitetet turistike
- ▶ Aktivitetet sportive
- ▶ Takimet statutore
- ▶ Aktivitetet në kuadër të programeve shkollore apo universitare
- ▶ Bursat
- ▶ Aktivitetet e kufizuara në formimin profesional



ÇFARË OFROJMË NE?

■ Ka 4 kategori grantesh që i ofrohen llojeve të ndryshme të organizatave:

- ▶ Aktivitete ndërkombëtare (të hapura ndaj të gjithëve përveç OJQ-ve lokale)
- ▶ Grante strukturore (jo të hapura ndaj OJQ-ve kombëtare dhe lokale)
- ▶ Aktivitete pilot (jo të hapura ndaj OJQ-ve/rrjeteve ndërkombëtare)
- ▶ Plane pune vjetore (të hapura vetëm ndaj OJQ-ve/rrjeteve ndërkombëtare, mund të përfshijnë edhe aktivitete pilot)

SI NDODH?

Regjistrimi

■ Së pari, aplikantët duhet të regjistrojnë organizatën e tyre në FRE.

Aplikimi

■ Nëse regjistrimi është i vlefshëm, aplikantët duhet të sigurohen që aplikimet e tyre të jenë të plotësuar dhe të detajuara përpara se ti paraqesin.

Vendimi

■ Vendimet për aktivitetet ndërkombëtare, planet e punës dhe grantet strukturore merren në Qershor dhe Dhjetor të çdo viti. Për aktivitetet pilot, vendimet merren çdo 2-3 muaj. Të gjitha vendimet janë të disponueshme në faqen e internetit.

Njoftimi

■ Formatet e pranimit të granteve, që listojnë një set me kushte për pagesat, u dërgohen aplikuesve të suksesshëm dhe 80% e granteve paguhet afërsisht 10 javë përpara fillimit të aktivitetit.

Vlerësimi

■ Raportet e aktiviteteve dhe ato financiare duhet tiq dërgohen FRE-së 2 muaj pas përfundimit të aktivitetit. Pjesa e mbetur prej 20% e grantit paguhet pasi EYF ka marrë raporte të kënaqshme.

■ Të gjitha afatet dhe informacionet e mëtejshme janë të listuara në faqen e internetit.

FONDACIONI RINOR EVROPIAN

30, rue Pierre de Coubertin
F-67000 Strasbourg
Tél.: +33 3 88 41 20 19
Fax: +33 3 90 21 49 64
eyf@coe.int
<http://eyf.coe.int>

Follow us:



Prens 117715

ALB

www.coe.int

Këshilli i Evropës është organizata kryesore e kontinentit për të drejtat e njeriut. Në të bëjnë pjesë 47 shtete anëtare, 28 prej të cilëve janë shtete anëtare të Bashkimit Evropian. Të gjithë shtetet anëtare të Këshillit të Evropës kanë nënshkruar Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dokumenti i cili është hartuar për të mbrojtur të drejtat e njeriut, demokracinë dhe shtetin e së drejtës. Gjykata Evropiane mbikëqyr zbatimin e Konventës nga shtetet anëtare.

